



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/89
Datë: 23.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 88 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/89

Datë: 23.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Formohet komisioni ndërministror për vlerësimin e dëmeve në pronat e pronarëve në fshatin Debëllde, komuna e Vitisë, nga viti 2001 deri më 2009, në këtë përbërje:
 - a) Përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - kryesues;
 - b) Përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave - anëtar;
 - c) Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë - anëtar;
 - d) Përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - anëtar;
 - e) Përfaqësues nga Kuvendi Komunal i Vitisë - anëtar;
2. Komisioni sipas pikës 1. të këtij vendimi obligohet që brenda afatit 2 muajor Qeverisë t'i raportojë në mënyrë të detajuar lidhur me këto dëme dhe vlerësimin për kompensimin financiar të tyre.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hasniq THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/89

Datë: 23.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 1, paragrafi 1 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Ministrisë së Forcës së Sigurisë i lejoheq që të bëjë rritjen e paradhënies deri në 20% të shumës për kontratat e specifikuara, sipas kërkesës së datës 23.10.2009.
2. Ngarkohet Ministria e Forcës së Sigurisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë